FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

PILOKARPINE

Tretësirë me pika për sy – 20 mg / ml (2%)
(Pilokarpinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor, që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Pilokarpine dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Pilokarpine
3. Si ta përdorni Pilokarpine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Pilokarpine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PILOKARPINE DHE PËRSE PËRDORET

Pilokarpina është një alkaloid me origjinë bimore. Në organizmin e njeriut ajo vepron duke nxitur drejtpërdrejt receptorët kolinergjikë të tipit M dhe duke shkaktuar efekte të ngjashme me aktivizimin e sistemit parasimpatik. Këto efekte janë më të shprehura në sy dhe në gjendrat e djersës dhe të pështymës.
Pilokarpina gjithashtu është në gjendje të kundërshtojë efektin midriatik të simpatomimetikëve dhe të atropinës. Përdoret për mjekimin e glaukomës së thjeshtë kronike me kënd të hapur dhe të glaukomës akute me kënd të ngushtë. Pilokarpina përdoret e vetme ose e kombinuar me miotikë të tjerë, beta - bllokues, frenues të anhidrazës karbonike, simpatomimetikë ose lëndë hiperosmotike, për të ulur presionin intraokular para ndërhyrjes kirurgjikale dhe për të shkaktuar miozë (ngushtim të bebes së syrit) me qëllim që të kundërshtohen efektet e pikave për sy të lëndëve midriatike dhe ciklopegjike (të dyja shkaktojnë zgjerim të bebes së syrit).

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI PILOKARPINE

Mos përdorni Pilokarpine në qoftë se:
- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj pilokarpinë klorhidratit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Pilokarpine;
- keni patur ndonjëherë shkolitje të retinës;
- keni disa forma të glaukomës sekondare ku nuk indikohet përdorimi;
- keni irit akut;
- keni uveit anterior;
- përdorni lente kontakti të buta, sepse Pilokarpine përmban klorur benzalkoni si lëndë konservuese dhe lentet duhet të hiqen përpara përdorimit të pikave për sy Pilokarpine.

Tregoni kujdes të veçantë me Pilokarpine
Para fillimit të mjekimit, të gjithë të sëmurët duhet të kryejnë ekzaminimin e fundus okuli, sepse ekziston rreziku për shkolitje të retinës.

Pyesni mjekun tuaj përpara se të përdorni Pilokarpine në qoftë se vuani nga:
- pamjaftueshmëria kardiake akute, astma bronkiale, ulcera peptike, hipertensioni, hipotensioni, obstruksioni i traktit urinar, hipertiroidizmi, epilepsia, dhe sëmundja e Parkinsonit;
- përdorimi në doza të larta mund të çojë në shfaqjen e reaksioneve sistemike.

Gjatë trajtimit, këshillohet të monitorohet presioni intraokular dhe parametrat e funksionit të të parit.

Fëmijët dhe adoleshentët
Siguria dhe efikasiteti i Pilokarpine, tretësirë me pika për sy 2%, tek fëmijët dhe adoleshentët nuk është vërtetuar në provat klinike të mirëkontrolluara. Prandaj, në rastet kur është i domosdoshëm, përdorimi duhet të jetë nën rekomandimin dhe mbikqyrjen e rreptë mjekësore.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga pilokarpina.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me pilokarpinë në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që, në rastin e përdorimit të pilokarpinës (pika për sy), mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju po trajtoheni njëkohësisht me:
- adrenalinë (mund të shkaktojë ulje të mëtejshme të presionit intraokular);
- beta-bllokues (rritet rreziku i aritmive nga pilokarpina);
- timolol (mund të shkaktojë ulje të mëtejshme të presionit intraokular);
- frenues të anhidrazës karbonike (mund të shkaktojnë ulje të mëtejshme të presionit intraokular);
- atropinë ose barna me efekte kolinolitike, disa fenotiazina, disa antihistaminikë (antagonizojnë efektet e pilokarpinës);
- barna si: klozapina, disopiramidi, amitriptilina, amoksapina, bupropioni, etj (bllokojnë ose reduktojnë efektin e pilokarpinës).

Shtatzënia
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.
Për shkak të mungesës së të dhënave, këshillohet të shmanget përdorimi gjatë shtatzënisë. Në rastet e domosdoshme, kur përfitimi tejkalon riskun, përdorimi duhet të jetë nën mbikëqyrjen e mjekut.

Ushqyerja me gji
Pilokarpina kalon në qumështin e gjirit. Në këtë rast këshillohuni me mjekun tuaj para përdorimit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Pilokarpina mund të ulë aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin ose për të përdorur makineri.
Mos drejtoni automjetin dhe mos përdorni makineri menjëherë pas aplikimit të Pilokarpine dhe sidomos pa e ditur sesi ndikon ky bar në shikimin tuaj.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Pilokarpine
Pilokarpine përmban 0.1 mg klorur benzalkoni në 1 ml tretësirë me pika për sy.
Kloruri i benzalkonit mund të përthithet nga lentet e buta të kontaktit dhe mund të ndryshojë ngjyrën tyre.
Hiqini lentet e kontaktit përpara aplikimit të barit dhe prisni të paktën 15 minuta para se t`i rivendosni.
Kloruri i benzalkonit mund të shkaktojë gjithashtu acarim të syve, veçanërisht nëse keni sy të thatë ose çrregullime të kornesë (shtresa e qartë në pjesën e përparme të syrit). Nëse keni ndjesi jonormale të syve, thumbim ose dhimbje në sy pas përdorimit të këtij bari, kontaktoni mjekun tuaj.

3. SI TA PËRDORNI PILOKARPINE

Gjithmonë përdoreni Pilokarpine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e pilokarpinës janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Dozimi:
- për mjekimin e glaukomës kronike dhe shkaktimin e miozës përdoren 1 - 2 pika të tretësirës 2%, 4 herë në ditë;
- për trajtimin e glaukomës akute me kënd të ngushtë fillohet me 1 pikë të tretësirës 2% çdo 10 minuta, përgjatë 1 ore, dhe më pas vazhdohet me 1 - 2 pika çdo 1 - 3 orë, deri në rënien e presionit intraokular.

Mënyra e administrimit të Pilokarpine pika për sy 2% është:
- Lajini mirë duart.
- Mos e prekni vendin e daljes së pikave.
- Shikoni lart.
- Ulni kapakun e poshtëm të syrit për të krijuar një ulluk.
- Vendosni pikatoren sa më afër ullukut, por pa e prekur atë.
- Hidhni sasinë e duhur të pikave në ulluk.
- Mbyllni syrin për rreth 2 minuta. Për të evituar që ky bar të përthithet në organizëm, mund të shtypni me gisht këndin e syrit, pranë hundës për rreth 1-2 minuta.
- Tretësira e tepërt që del mund të hiqet me një garzë sterile.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Pilokarpine
Në qoftë se keni përdorur më shumë Pilokarpine se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Rastet e mbidozimit vërehen në qoftë se Pilokarpine merret gabimisht nga goja. Në këtë rast shenjat janë: djersitje, shikim i turbullt, pështymë e shtuar, të fikët, nauze, të vjella, diarre, etj.

Në qoftë se harroni të përdorni Pilokarpine
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), përdorni dozën në vazhdim kur të jetë koha për përdorimin e zakonshëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, pilokarpina mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Efektet anësore kryesore janë: djegie, dhimbje, kruarje, kongjestion konjunktival vaskular, spazma ciliare, ulje e mprehtësisë së shikimit në kushtet e ndriçimit të kufizuar, dhimbje koke, shkolitje e retinës dhe hemorragji vitreoze.
Efektet anësore sistemike janë të rralla: hipertension, takikardi, spazma bronkiale, nauze, të vjella, etj.
Efekte të tjera anësore që mund të shfaqen janë: diarre, shtim i pështymës, lotim, djersitje, edemë pulmonare, ndryshim në shpeshtësinë e rrahjeve të zemrës si dhe në presionin e gjakut, reaksione alergjike, rritje e bllokut pupilar, çrregullime të syve, përndryshim i lenteve në përdorim për kohë të gjatë, etj.

Në qoftë se vëreni efekte anësore, që nuk janë të përmendura në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PILOKARPINE

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Pilokarpine pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Të ruhet në temperaturë 10°C – 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban tretësira me pika për sy Pilokarpine
Lënda aktive është pilokarpinë klorhidrat.
1 ml tretësirë përmban 20 mg pilokarpinë klorhidrat (2%).
Përbërësit e tjerë janë: klorur natriumi, boraks, acid borik, EDTA dinatriumi, klorur benzalkoni, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me një flakon plastik steril me pikatore 10 ml.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.